

Tiranë, më \_\_. \_\_. 2023

**Formulari Nr.3**

**Autoriteti Kontraktor  
ALBCONTROL SHA**

**FTESA PËR OFERTË**

Autoriteti Kontraktor ALBCONTROL SHA do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar nr. 2655/1 Prot. me objekt: “Blerje bilete të transportit ajror ndërkombëtar, me destinacion Pragë dhe Tiranë”.

Data e zhvillimit do të jetë 07.12.2023, ora 14:00 në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna:

1. Biletë Madrid – Tiranë, nisja më datë 21.12.2023, për 9 (nëntë) persona.
  2. Biletë Pragë – Tiranë, nisja më datë 23.12.2023, për 21 (njëzetë e një) persona.
  3. Biletë Tiranë – Pragë – Tiranë, nisja më datë 10.12.2023 dhe kthimi më datë 13.12.2023, për 2 (dy) persona.
- Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë, dokumentat sipas **shtojcës nr. 1, ku gjeni dhe detajet e itinerareve të fluturimit:**

## **Shtojca nr. 1**

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë, dokumentat si më poshtë:

- a) Rezervimin e biletës, sipas destinacionit të kërkuar me itinerare të detajuara, duke përfshirë klasin, sasinë, statusin dhe të dhëna të tjera alfanumerike që kanë të bëjnë me segmentet e udhëtimit si dhe kodin e llogarisë së klientit.

*Në rast anulimesh apo vonesash nga kompanitë ajrore të fluturimit, Operatori Ekonomik do të bashkëpunojë me Autoritetin Kontraktor për riorganizimin e Itinerarit.*

- Shpenzimet e transportit përfshijnë udhëtimin me avion me destinacion Pragë dhe Tiranë, sipas itinerarit si mëposhtë:

- a. Itinerari (1): **Madrid – Tiranë, për 9 (nëntë) persona, si mëposhtë:**

- **Nisja** nga Madrid për 9 persona, më datë **21.12.2023**, të bëhet jo më herët se ora 13:00 PM, të ketë jo më shumë se një tranzit dhe mbërritja në Tiranë jo më vonë se ora 23:00 PM.

- b. Itinerari (2): **Pragë – Tiranë, për 21 (njëzetë e një) persona, si mëposhtë:**

- **Nisja** nga Pragë për 21 persona, më datë **23.12.2023**, të bëhet jo më herët se ora 07:00 AM, të ketë jo më shumë se një tranzit dhe mbërritja në Tiranë jo më vonë se ora 15:00 PM.

- c. Itinerari (3): **Tiranë – Pragë – Tiranë, për 2 (dy) persona, si mëposhtë:**

- **Nisja** nga Tirana për 2 persona, më datë **10.12.2023**, të bëhet jo më herët se ora 04:30 AM, të ketë jo më shumë se një tranzit dhe mbërritja në Pragë jo më vonë se ora 11:00 AM.
- **Kthimi** nga Pragë më datë **13.12.2023**, të bëhet jo më herët se ora 16:00 PM, të ketë jo më shumë se një tranzit.

- *Sqarim: Në rastet e fluturimeve me tranzit, preferohet që koha tranzite të jetë mbi 45 min., për shkak të procedurave dhe vonesave të ndryshme që mund të krijohen në nyjet e kontrollit që ushtrohen në aeroporte.*
- Minimalisht 1 (një) bagazh dore dhe 1 (një) valixhe bagazh max deri në 20 kg (on board, hand luggage dhe check-in baggage)/për person në vajtje dhe ardhje i përfshirë.
- Klasi ekonomik.

b) Dokumenta të tjera:

- Operatori ekonomik të paraqesë Ekstraktin e QKB-së, ku aktiviteti tregtar të jetë objekt i kësaj procedure si dhe statusi të jetë aktiv.
- Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë që është i pajisur me certifikatë akreditimi/marrëveshje lëshuar nga/me International Air Transport Association (I.A.T.A.), të vlefshme për vitin 2023 dhe valideti të jetë i verifikueshëm online.
- Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të kontaktit.
- Në zbatim të pikës 12 të Udhëzimit të APP-së nr. 03, datë 18.06.2021 “Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike”, të ndryshuar, konkretisht: “Me marrjen e njoftimit, ofertuesi duhet t’i përgjigjet autoritetit kontraktor brenda një afati të përcaktuar nga ky i fundit në ftesën për ofertë. Ky afat duhet të jetë minimalisht 2 (dy) orë nga momenti i njoftimit të këtij operatori nga komisioni i Sistemit Dinamik të Biletave”.
- Afati i dorëzimit të dokumentave në sistemin e prokurimit elektronik sipas Ftesës për Ofertë, do të jetë brenda **2 orëve** nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit.

**Shënim:** Autoriteti Kontraktor në zbatim të ligjit Nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar, do pranohet të likujdojë vetëm fatura elektronike për shërbimin e marrë.

- \* Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, apo mosdorëzimi i biletave të udhëtimit sipas termave të referencës dhe grafikut të itinerarit, konsiderohen si kushte për skualifikim.
- \* Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit, jeni të lutur të njoftoni në sistemin elektronik të app-së brenda afatit të përcaktuar në Ftesën për Ofertë nga shpallja e njoftimit të fituesit.

## TITULLAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR

**Laureta Omeri**